



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3251/ 7 prot.

Datë 08.01.2024

V E N D I M
Nr.17 /2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.01.2024, shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me nr.3251 prot., datë 29.12.2023 e operatorit ekonomik “Murati-D” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-88303-11-20-2023, me objekt: “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike” me fond limit 4,408,240.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 06.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Murati-D” SHPK me NIPT K42003004T dhe adresë: Rruga e Kavajë Ish Kombinati Ushqimor God-1 katëshe Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 me adresë: Rr. “Arben Broci” Qyteti Studenti Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “AZ Trading” SHPK me NIPT L81515016F dhe adresë: Tirane, Njesia Administrative nr.7, Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla G&P, Kati 1, Njesia nr.13

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I*****Vlerësimi paraprak***

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II***Rrethanat e çështjes***

II.1 Në datën 21.11.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-88303-11-20-2023, me objekt: “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike” me fond limit 4,408,240.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 06.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1.

II.2. Në datën 29.12.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është paraqitur ankesa me nr.3251 prot., datë 29.12.2023 e operatorit ekonomik “Murati-D” SHPK mbi skualifikimin e

ofertës së tij nga procedura e prokurimit dhe kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “AZ Trading” SHPK. Bazuar në nenin 112, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi në datën 03.01.2024 “Formularin për Publikim” me Nr. 3251/3 prot.

II.3. Operatori ekonomik ankimues “Murati-D” SHPK, me anë të shkresës me nr. 562 prot., datë 05.01.2024 protokolluar me tonën me nr. 3251/4 prot., datë 05.01.2024, me lëndë “Kërkesë për tu tërhequr nga ankesa e bërë për Rezidencën Studentore Nr.1 Tiranë” ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit duke u shprehur se: *“Me anë të kësaj kërkesë kërkoj që të tërhiqem nga ankesa e bërë pranë jush për firmën AZ Trading me nr. prot 3251/2023 e bërë me datën 29.12.2023 për Rezidencën Studentore Nr.1 me objekt prokurimi “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike did he me nr REF-88303-11-20-2023”*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “Murati-D” SHPK për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-88303-11-20-2023, me objekt: “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike” me fond limit 4,408,240.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 06.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimesin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me nr. 3251 prot., datë 29.12.2023 për procedurën e prokurimit objekt-ankim, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-88303-11-20-2023, me objekt: “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike” me fond limit 4,408,240.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 06.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

